



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.96

30 qershor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.565, datë 28.5.2009	Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë shkollës së lartë private "Issat"	4227
Vendim i KM nr.607, datë 11.6.2009	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, si dhe të punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive, pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit	4228
Vendim i KM nr.717, datë 23.6.2009	Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore	4230
Vendim i KM nr.720, datë 22.6.2009	Për kalimin e titullit të pronësisë së sipërfaqeve, që do të tjetërsohen, në favor të subjektit kërkues "Mane TCI", sh.p.k., për llogari të fondit të kompensimit financiar	4246

VENDIM
Nr.565, datë 28.5.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “ISSAT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë private “ISSAT”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të parë”, në fushat:
 - a) E drejtë ndërkombëtare;
 - b) Studime europiane dhe diplomaci;
 - c) Menaxhim shëndetësor;
 - ç) Psikologji sociale dhe e komunikimit.
2. Programet e studimit “Master i nivelit të parë” janë pjesë e studimeve të ciklit të dytë, me, së paku, plotësimin e 60 krediteve. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë “Masteri i nivelit të parë” (MNP), në:
 - a) E drejtë ndërkombëtare;
 - b) Studime europiane dhe diplomaci;
 - c) Menaxhim shëndetësor;
 - ç) Psikologji sociale dhe e komunikimit.
3. Lejimin e shkollës së lartë private “ISSAT”, Tiranë, për hapjen e programeve të studimit “Master i nivelit të dytë”, në fushat:
 - a) Administrim-biznes, me profile:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë-kontabilitet;
 - iii) Menaxhim i sistemeve të informacionit;
 - iv) Menaxhim turizmi.
 - b) Studime europiane dhe diplomaci;
 - c) E drejtë ndërkombëtare;
 - ç) Menaxhim shëndetësor;
 - d) Psikologji sociale dhe e komunikimit.
4. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” do të jenë programe studimi të ciklit të tretë, në plotësimin e, të paktën, 60 krediteve. Në mbarim të programeve të studimit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë” (MND), në:
 - a) Administrim biznes, me profile:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë-kontabilitet;
 - iii) Menaxhim i sistemeve të informacionit;
 - iv) Menaxhim turizmi.
 - b) Studime europiane dhe diplomaci;
 - c) E drejtë ndërkombëtare;
 - ç) Menaxhim shëndetësor;
 - d) Psikologji sociale dhe e komunikimit.
5. Shkolla e lartë private “ISSAT” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1 e 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të

tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private "ISSAT" duhet t'u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.607, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE, TË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË DHE TË GJYKATAVE TË APELIT, SI DHE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË TË ADMINISTRATËS SË PROKURORIVE, PRANË GJYKATAVE TË SHKALLËS SË PARË DHE GJYKATAVE TË APELIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen punonjësit me arsim të lartë të administratës gjyqësore, në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit, si dhe punonjësit e administratës së prokurorive, pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit.

2. Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve me arsim të lartë të administratës gjyqësore, në pozicionin nga "Specialist" deri në "Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse", në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit, si dhe të punonjësve me arsim të lartë të administratës së prokurorive, në pozicionet nga "Specialist" deri në "Kryetar dege", pranë këtyre gjykatave, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga e grupit (kolona 1, lidhja nr.1) "Diplomë e shkollës së lartë", është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

4. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2, lidhja nr.1), e cila llogaritet mbi pagën e grupit, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, por jo më shumë se për 25 vjet.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Kategorizimi për çdo pozicion pune përcaktohet në urdhrin e miratimit të strukturës dhe të organikës së çdo gjykate dhe çdo prokurorie.

7. "Specialistët", në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës gjyqësore e të administratës së prokurorive, pranë gjykatave, dhe që kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët "Inxhinieri elektronike" apo "Informatikë", përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Miratimi i kësaj shtese do të bëhet rast pas rasti nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, në përputhje me përshkrimin e pozicionit të punës.

8. Punonjësit, që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë, kur vendi i punës e kërkon, do të trajtohen në pagë në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

9. Punonjësit e tjerë mbështetës, të administratës së gjykatave dhe të administratës së prokurorive, pranë gjykatave, që nuk përfshihen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të

trajtohen në pagë, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

10. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e buxhetit të këtij viti, miratuar për rritjen e pagave.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

12. Vendimi nr.20, datë 14.1.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të administratës gjyqësore, të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit”, si dhe dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË TË
ADMINISTRATËS GJYQËSORE NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË DHE NË GJYKATAT
E APELIT DHE TË ADMINISTRATËS SË PROKURORIVE PRANË GJYKATAVE TË
SHKALLËS SË PARË DHE PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

	Paga mujore				
Pozicioni	Kategoria	Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit (SHP)
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shetsa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Përgjegjës i shërbimeve mbështetëse në Gjykatën e Krimeve të Rënda	III-a	12 000	2 %		69 000
Kryesekretar gjyqësor Kryesekretar në prokurori Kryetar dege	III-b	12 000	2 %		52 000
Sekretar gjyqësor Sekretar pranë prokurorëve Specialist	IV-a	12 000	2 %		41 000
Specialist	IV-b	12 000	2 %		31 000

**VENDIM
Nr.717, datë 23.6.2009**

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE
TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave,

VENDOSI:

1. Klasat dhe nivelet e pagave për klasë të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore qendrore, të cilët nuk trajtohen në pagë me strukturën e pagave të nëpunësve të shërbimit civil, janë sipas lidhjes nr.I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës, institucione qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, me 10 klasa.

2. Klasat dhe nivelet e pagave për klasë të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore, rajonale e vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, caktohen sipas lidhjes nr.II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale e vendore”, me 14 klasa.

3. Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për punonjës mbështetës, në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes I/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë, për punonjës mbështetës në administratën e ministrive të linjës, institucioneve të pavarura, institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për punonjës mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjeve përkatëse, si nënlidhje të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

5. Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për punonjës mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjes II/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës për çdo klasë për punonjës mbështetës në administratën e institucioneve rajonale dhe vendore, si dhe të institucioneve qendrore, të grupit të tretë, të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për punonjës mbështetës në institucionet buxhetore, të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të jetë sipas lidhjeve përkatëse, si nënlidhje të lidhjes nr.II, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

7. Nëpunësve/punonjësve, pagat e të cilëve caktohen sipas lidhjeve nr.I e nr.II dhe nënlidhjeve përkatëse, pas çdo viti pune, u jepet shtesë për vjetërsi pune, në masën 1 për qind mbi pagën bazë për klasë, por jo më shumë se 25 për qind. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

8. Për punonjës mbështetës në funksione drejtuese jepet shtesë mbi pagën bazë për klasë, në përqindje, sipas shkallëzimit, në 5 grupe, si më poshtë vijon:

Grupi i parë	deri në 5%;
Grupi i dytë	5 deri në 10%;
Grupi i tretë	10 deri në 15%;
Grupi i katërt	15 deri në 20%;
Grupi i pestë	20 deri në 30%.

Përcaktimi i masës së shtesës, sipas grupit përkatës, të bëhet në lidhjen përkatëse të pagave, që i bashkëlidhet këtij vendimi, ndërsa përcaktimi i masës në përqindje të bëhet në urdhrin përkatës të Kryeministrit/ministrit të linjës, për miratimin e strukturës së institucionit.

9. Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve, pagat e të cilëve caktohen, sipas lidhjeve nr.I e nr.II dhe nënlidhjeve përkatëse, u jepen shtesa mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon:

-Në shkallën e parë	në masën 5%;
-Në shkallën e dytë	në masën 15%;
-Në shkallën e tretë	në masën 20%;
-Në shkallën e katërt	në masën 25%.

Këto shtesa, për të katër shkallët, llogariten mbi pagën bazë të klasës VI, të lidhjeve përkatëse, ndërsa për punonjës mbështetës e repartit të inspektim-minierave, llogariten mbi pagën bazë mujore të klasës VIII të lidhjes nr.I.

Ndarja e punëve, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, bëhet sipas lidhjes nr.III, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Zbatimi i kësaj shtese bëhet si më poshtë vijon:

a) Drejtoritë/njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, të institucioneve buxhetore, në zbatim të kësaj pike, i paraqesin kërkesën e tyre drejtorive të shëndetit publik, të cilat përcaktojnë vendet e punës, të vështira e të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve, si dhe shkallën e vështirësisë e të dëmshmërisë, për çdo vend pune.

b) Pas përcaktimit të shkallës së vështirësisë e dëmshmërisë, titullarët e institucioneve buxhetore paraqesin kërkesën për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

c) Pas marrjes së miratimit nga dy ministritë e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, titullarët e institucioneve miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Për institucionet qendrore, në varësi të ministrave të linjës, si dhe ato, rajonale e vendore, ky miratim bëhet nga ministri përkatës, në varësi të të cilit janë këto institucione.

ç) Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa për vështirësi e dëmshmëri, ai do të marrë nga një vështirësi, për çdo shkallë, por jo më shumë se 60 për qind.

d) Këto shtesa u rekomandohen edhe punëdhënësve të tjerë të ndërmarrjeve e institucioneve shtetërore jobuxhetore apo subjekteve private.

10. Mjekët, që janë anëtarë të komisioneve të ndryshme të vlerësimit dhe përcaktimit të shkallës së aftësisë për punë të shtetasve, për punën që bëjnë, pavarësisht numrit të mbledhjeve në një muaj, marrin shpërblim mujor, në përqindje, në masën, si më poshtë vijon:

a) Për komisionin epror dhe komisionet e rretheve të grupit të parë:

- Kryetari 36 për qind;
- Anëtarët 31 për qind.

Këto përqindje zbatohen mbi pagën mujore të mjekut të përgjithshëm, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

b) Për rrethet e tjera:

- Kryetari 31 për qind;
- Anëtarët 26 për qind.

Këto përqindje zbatohen mbi pagën mujore të mjekut të përgjithshëm, në qendrat e shërbimit spitalor në rrethe.

11.a) Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupin “A”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, kur nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, por janë punonjës civilë, përfitojnë pagën sipas klasës VII të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe 50 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

b) Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupet “B” dhe “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferi i kryetarit të Akademisë së Shkencave e shoferët e funksionarëve, të barazuar me ta në pagë, sipas ligjeve të veçanta, përfitojnë pagën sipas klasës VI të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe 40 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

c) Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupet “D” e “E”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferët e titullarëve të tjerë, përkatësisht, të zëvendësministrave, të drejtorit të kabinetit të Presidentit, kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit, të sekretarëve të Përgjithshëm, në ministritë e linjës, të sekretarëve të Përgjithshëm në institucionet e pavarura kushtetuese, të sekretarëve të Përgjithshëm, në institucionet e tjera të pavarura, të krijuara me ligje të veçanta, të prefektit të qarkut të Tiranës, të rektorit të universitetit, të titullarëve të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe në varësi të ministrave të linjës, të titullarëve të gjykatave të apelit, të gjykatave të apelit për krimet e rënda, të gjykatave të rretheve gjyqësore, të gjykatave për krimet e rënda, të drejtorit të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor përfitojnë pagën sipas klasës V të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe 30 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

ç) shoferët e prefektëve të qarqeve të tjera përfitojnë 20 për qind shtesë mbi pagën bazë të

klasës përkatëse.”.

12. Për një periudhë tranzitore, punonjësit, që përfshihen në njësitë ose drejtoritë e zbatimit të projekteve, kredive a ndihmave, që përfiton Republika e Shqipërisë nga institucionet ndërkombëtare ose qeveritë e vendeve të ndryshme, do të trajtohen me pagë, si më poshtë vijon:

a) Për projektet me rëndësi të veçantë, drejtuesi i projektit barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b, në ministri. Rëndësia e projektit caktohet nga Kryeministri.

b) Për projektet e tjera, drejtuesi i projektit barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a, në ministri.

c) Në rastet e përmendura në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, specialistët e projekteve barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-b, në ministri, ndërsa punonjësit mbështetës trajtohen në të njëjtën mënyrë si punonjësit mbështetës në ministrinë e linjës.

13. Punonjësve të sektorit të teknikës e shtypshkrimit, në administratën e Qendrës së Publikimeve Zyrtare, pagat e të cilëve rregullohen sipas lidhjes përkatëse të këtij vendimi, përfitojnë shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

14. Punonjësit shpëtues të sektorit të emergjencave dhe të shpëtimit, të repartit të inspektim-shpëtimit të minierave, të cilët punojnë në kushte të vështira për jetën, përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

15. Teknikët e mesëm, të cilët punojnë në repartet e prodhimit, të ndërtimit e riparimit të anijeve në qendrën e ndërtimit dhe riparimit të anijeve patrulluese për Rojën Bregdetare të Shqipërisë, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

16. Punonjësit e qendrës së shërbimeve dhe administrimit të mjeteve të transportit, në pozicionin “Shofer”, kur emërohen në dispozicion të titullarëve të Ministrisë së Brendshme, trajtohen në pagë sipas parashikimit të bërë në këtë vendim, për pagat e shoferëve të titullarëve, ndërsa punonjësit e kësaj qendre, në pozicionin “Shofer-mekanik”, përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

17. Punonjësit mbështetës, të cilët punojnë në shërbimet e shëndetit mendor, e që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me këta të sëmurë, përfitojnë shtesë, për natyrë të veçantë pune, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj. Ministri i Shëndetësisë përcakton vendet e punës, që e përfitojnë këtë shtesë, me miratimin e strukturave të institucioneve shëndetësore përkatëse.

18. Punonjësit mbështetës, të cilët punojnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit, përfitojnë shtesë, për kushte të veçanta pune, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj. Kjo shtesë zbatohet pas miratimit të strukturave të institucioneve të ekzekutimit të veprave penale përkatëse, sipas propozimit të Ministrit të Drejtësisë.

19. Për një periudhë kalimtare, punonjësve të cilët deri në datën 1 korrik 2007, përfitonin një pagë më të lartë, se sa parashikohet në lidhjet përkatëse të pagave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, u jepet pagë në ruajtje, por jo më shumë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Me pagë në ruajtje trajtohen dhe punonjësit civilë të Policisë së Shtetit, të cilët nuk trajtohen më me sistemin pagë-gradë.

Kjo pagë llogaritet si diferencë ndërmjet pagës bruto, të llogaritur sipas këtij vendimi, dhe pagës bruto, që këta punonjës përfitonin para miratimit të vendimit nr.1231, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave.

Punonjësit, të cilët fillojnë punë për herë të parë, trajtohen në pagë, sipas parashikimeve dhe lidhjeve përkatëse të këtij vendimi dhe nuk përfitojnë pagë në ruajtje.

20. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për punonjësit e Policisë së Shtetit fillojnë nga data 1 janar 2009. Efektet financiare për punonjësit e tjerë fillojnë nga data 1 maj 2009.

21. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2009, të përballohen nga fondet e miratuara në Buxhetin e Shtetit, për rritjen e pagave të punonjësve buxhetorë, për këtë vit.

22. Vendimi nr.1231, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve, në disa institucione buxhetore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.I

**NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT,
NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS
DHE NË PREFEKTURA**

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	18000
2	II	19600
3	III	20500
4	IV	21100
5	V	21800
6	VI	23500
7	VII	26500
8	VIII	29500
9	IX	33000
10	X	36000

Lidhja nr.II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	18000
2	II	19600
3	III	20500
4	IV	21100
5	V	21800
6	VI	23000
7	VII	23800
8	VIII	24500
9	IX	26000
10	X	27500
11	XI	28500
12	XII	30500
13	XIII	32000
14	XIV	34000

Lidhja nr.III

**KRITERE PËR DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME
PËR SHËNDETIN**

Në zbatim të pikës nr.8 të këtij vendimi, punë që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, konsiderohen ato punë që kryhen në ambiente që kapërcejnë kufijtë e lejueshëm të faktorëve të dëmshëm për shëndetin, të cilët përcaktohen në dispozita të veçanta ose në norma të detyrueshme higjieno-sanitare.

Ndarja e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin është si vijon:

1.Në shkallën e parë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave, që nuk shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;

b) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike, që nuk depozitohen në organizëm;

c) në ambientet e mbyllura, në të cilat për arsye teknologjike mbahet konstante temperatura

mbi 25 gradë ose nën 10 gradë;

d) në një ambient të lagët me lagështi relative të ajrit mbi 80 për qind, në baltë ose në kontakt direkt me ujin;

e) në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolet ose infra të kuqe, për shembull saldimi, farkëtimi etj;

f) në kushtet e vibrimit të përgjithshëm;

g) në ambientet në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i ndriçimit artificial;

gj) pranë monitorëve elektrikë me ekran (kur punon mbi 4 orë në ditë).

2. Në shkallën e dytë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave që shkaktojnë dëmtim të mushkërisë;

b) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike që depërtohen në organizëm;

c) në kushtet e ekspozimit ndaj zhurmave;

d) në kushtet e presionit të ulur ose të ngritur për arsye të procesit teknologjik;

e) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të vibrimit lokal, p.sh. përdorimi i pajisjeve pneumatike me dorë;

f) në kushtet e një mbingarkese fizike të llogaritur të paktën 1100 kilokalori për burrat dhe 600 kilokalori për gratë ose që kërkojnë një pozicion të detyruar për trupin;

g) në praninë efiçente potencialisht me burime infeksioni të rrezikshme, në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të hormoneve dhe antibiotikëve që shkaktojnë çrregullime të veprimtarisë fiziologjike të organizmit, si dhe faktorëve të tjerë me veprim të njëjtë si hormonet dhe antibiotikët, në qoftë se kjo do të njihet nga Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë.

3. Në shkallën e tretë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të fushave elektromagnetike me frekuencë të lartë në intervalin nga 0,1 deri 300 000 MhZ në zonën e rrezikut;

b) në kushte veçanërisht të rrezikshme;

- në lartësinë mbi 2 m ose në thellësinë nën 2 m kur punohet në prani të rrezikut;

- që lidhen me prodhimin, përdorimin, magazinimin dhe transportimin e gazeve dhe materialeve shpërthyes;

- brenda rezervuarëve, aparateve, kanaleve, puseve etj., kryerja e të cilave kërkon leje speciale nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucioni;

- në pajisjet elektroenergjetike që ndodhen nën tension mbi 220 V, që kryhen në përputhje me udhëzimet për mbrojtjen në punë;

- që lidhen me ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve djegëse të lëngëta, si dhe transportimin e tyre;

- nën tokë ose nën ujë;

- në punët me të sëmurët psikikë e me të meta mendore, në shërbimin e anatomisë patologjike e mjekësisë ligjore, në repartet me rrezikshmëri të lartë infektive, në repartet e sëmundjeve onkologjike;

4. Në shkallën e katërt përfshihen punët që kryhen:

- me benzidinë, alfa dhe beta naftiloamine, klorvinil,

- në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues, si dhe faktorë, të tjerë me veprime analogjike në qoftë se kjo do të njihet nga Instituti i Shëndetit Publik.

Lidhja I/1

**RENDITJA E POZICIONEVE TË PËRGJITHSHME TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR
PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E MINISTRIVE TË LINJËS,
INSTITUCIONEVE TË PAVARURA E KUSHTETUESE, INSTITUCIONEVE QENDRORE NË
VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË LINJËS DHE NË PREFEKTURA**

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i pagës klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1	Përgjegjës i sektorit të teknikës në Qendrën e Publikimeve Zyrtare	X	5
2	Offsetist në Qendrën e Publikimeve	X	

	Zyrtare		
3	Përgjegjës zyre	IX	5
4	Sekretar rektori Teknik shtypshkronje, faqosës në Qendrën e Publikimeve Zyrtare	IX	
5	Përgjegjës ofiçine e transporti	VIII	1
6	Sekretar i titullarëve të tjerë Bibliotekar në ministritë e linjës Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit Ndhmësinspektor Ndhmësspecialist	VIII	
7	Bibliotekar në bibliotekat e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes Restaurator Arkivist.Protokollist Laborant Llogaritar Kontrollor anketimi	VII	
8	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme Operator në INSTAT Administrator dokumentesh në drejtoritë e arkivave në qarqe	VI	
9	Operator Magaziniër Preparator Kolektor Punonjës blegtorie	V	
10	Shofer Shaptilografist Fotokopjuese Kaldaist	IV	
11	Nëpunës informacioni.Centralist Punëtor mirëmbajtës	III	
12	Rojë	II	
13	Pastrues/sanitar Korrier.Postier	I	

Lidhja I/2

RENDITJA E POZICIONEVE TË PUNËS PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË PRESIDENCË,
KUVEND, KRYEMINISTRI

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës arkivi.Përgjegjës administrate	IX	4
2	Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit	VIII	3
3	Arkivist Llogaritar Operator	VIII	

	Kameraman.Fotograf		
	Punonjës shtypshkronje, shumëfishimi Teknikë të ndryshëm Magazinier Receptionist Shofer-korrier	VII	0
4	Punëtorë të tjerë. Shofer	VI	0
5	Punonjës pastrimi	III	0

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja I/3

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS TË GJYKATËS KUSHTETUESE DHE NË GJYKATËN E LARTË**

Nr.	Pozicioni	Klasa	Shtesa për funksion drejtues sipas grupit përkatës
1	Punonjës i ruajtjes së rendit Sekretare gjyqësore	VIII	
2	Teknik mirëmbajtjeje Operatorë Sekretarë gjyqësor në Gjykatën e Lartë Magazinier	VII	
3	Shofer i kryetarit	VII	
	Shofer i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë Shofer-korrier	VI	
4	Shoferë të tjerë	V	
5	Punonjës pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja nr.I/4

**RENDITJA E POZICIONEVE TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR NËPUNËSIT DHE
PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E PROKURORISË SË PËRGJITHSHME**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit Sekretare Punonjës i postës sekrete	VIII	
2	Teknik mirëmbajtjeje Operator Magazinier	VII	
	Shofer i postës sekrete	VI	
3	Shoferë të tjerë të institucionit	V	
4	Punonjës pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja nr.I/5

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS**

1	Për punonjësit në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar	
Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës
	Teknik gjeolog dhe të specialiteteve të ndryshme Punëtor (mjeshtër shpimi, sondist, minator, armator, mekanik, motorist, elektrikist, tornitor, saldator, axhustator, llamarinist)	VII
	Operator, kompjuterist, heliografist, disenjator, kopist Shofer të ekspeditave	VI
	Ndihmës sondist Ndihmësminator Ndihmësarmator Ndihmësteknik	IV
2	Në repartin e inspektim-shpëtimit në miniera	
	Teknikë të mesëm në: -Laboratorin e provave të litarëve të çelikut; -Emergjencën dhe shpëtimin; -Mirëmbajtjen (kolaudimin) e pajisjeve shpëtuese; -Mirëmbajtjen dhe kolaudimin e automjeteve.	IX
	Teknik të mesëm për komunikimin, informacionin dhe ruajtjen e institucionit Shofer i automjeteve të gatishmërisë	VII

Lidhja nr.I/6

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT, NË
ISNTITUTIN E POLICISË SHKENCORE DHE QENDRËN E SHËRBIMEVE TË TEKNOLOGJISË
SË INFORMACIONIT**

Nr.	Pozicioni	Klasa	Shtesa për funksion drejtues sipas grupit përkatës
2	Ndihmësmjek Bibliotekar Sekretar Kryekuzhinier Ndihmësfarmacist	VII	
3	Teknik armatimi Teknik ndërtimi Kujdestar – magazinier (për armatime dhe të tjera) Infermier Kuzhinier	VI	
4	Shofer autoambulance	V	
5	Kartelist. Evidencier Inventarizues Rrobaqepës Kamerier Kolaudator.Furnitor	IV	
6	Mirëmbajtës ushqimi Ndihmëskuzhinier Punonjës ngarkim-shkarkimi Zhbllokues	III	
7	Lulishtar Mirëmbajtës	II	

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja nr.I/7

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË SISTEMIN E MINISTRIË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE**

Në administratën e Teatrit të Operës dhe Baletit dhe Teatrit Kombëtar			
Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1.	Përgjegjës për bibliotekën muzikore në TOB Mjeshtër skene Mjeshtër ndriçim fonie Mjeshtër parukier-grimier Mjeshtër rrobaqepës Mjeshtër gardier Mjeshtër i dekorit Mjeshtër marangozerie Mjeshtër këpucar	IX	
3.	Ndihmësmjeshtër: Grimier/rrobaqepës/rekuizitier/ këpucar/marangozerie/ i mekanikës skenike. Punonjës marketingu	VIII	
4.	Ndimësmjeshtër ndriçim foni/rekuizitier/dekorator	VII	
5.	Punëtor skene	IV	
6.	Punëtor shërbimi	III	
7.	Biletashitës	II	

Shënim. Për emërtesat të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Në administratën e Galerisë Kombëtare të Arteve, Muzeut Historik Kombëtar, Biblotekës Kombëtare, Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Muzeut të Artit Mesjetar, Korçë, Muzeut “Onufri” Berat, Muzeut “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Krujë, Fototekës “Marubi” Shkodër dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës Tiranë			
	Restaurator për Institutin e	VIII	

	Monumenteve të Kulturës Tiranë		
	Ndihmësbibliotekar. Piktor/skulptor/piktor ekzekutues në QKK	VII	
	Elektricitist. Fonist. Butaforist	VI	
	Vëzhgues salle. Ruajtës fondesh Fototekist. Katalogues Punëtor restaurimesh	IV	
	Punëtor skene. Garderobier	III	
	Biletashitës	II	

Shënim. Për emërtesat të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja nr.1/8

**RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË INSTITUCIONET QENDRORE NË VARËSI TË MINISTRIT TË MBROJTJES,
TË GRUPIT TË PARË E TË DYTË**

Nr.	Pozicioni	Klasa	Shtesa për funksion drejtues sipas grupit përkatës
	Kontrollor cilësie, mbikëqyrës riparimi në qendrën e riparimit të nivelit të katërt të pajisjeve tokësore e në bazën e riparimit të aviacionit	IX	
	Montazhier grafist Ndihmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të IV-ët, në pajisjet tokësore dhe të nivelit të III-të në pajisjet ajrore	VIII	
2.	Bibliotekar Sekretar Kryekuzhinier Farmacist Topograf Kryeinfermier Operator audioviziv Ndihmësspecialist në prodhim e riparim të nivelit të III-të në pajisjet tokësore dhe të nivelit të II-të në pajisjet ajrore	VII	
3.	Teknik armatimi Teknik ndërtimi Kujdestar-magazinier (për armatime dhe të tjera) Infermier Kuzhinier Faqosës Provokopist Fotograf e kopist Arkivist i fondeve filmike e fotografike Fotoreporter Furnitor/kolaudator në qendrën e riparimit të nivelit të katërt të pajisjeve tokësore e në bazën e riparimit të aviacionit	VI	
4.	Shofer autoambulance	V	
5.	Kartelist. Evidencier	IV	

	Inventarizues Rrobaqepës Ndihmësinstruktur Libralidhës. Furnitor		
6.	Mirëmbajtës ushqimi Ndihmëskuzhinier Punonjës ngarkim-shkarkimi zhbllokues. Robalarës	III	
7.	Lulishtar Mirëmbajtës	II	

Lidhja I/9

RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT CIVILË NË QENDRËN E NDËRTIMIT DHE RIPARIMIT TË ANIJEVE PATRULLUESE PËR ROJËN BREGDETARE TË SHQIPËRISË, TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Nr.	Pozicioni	Klasa
1.	Teknikë të kualifikuar në repartet e prodhimit të anijeve	IX
2.	Teknikë të kualifikuar në repartet e riparimit të anijeve	IX
3.	Përpunues të projekteve e skicave Sekretar Përkthyes Kostoist normist	VIII
4.	Protokoll-arkiv/sekretar/operator Magazininier për karburantet	VII

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

Lidhja II/1

RENDITJA E POZICIONEVE TË PËRGJITHSHME TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E INSTITUCIONEVE RAJONALE DHE VENDORE, SI DHE TË INSTITUCIONEVE QENDRORE TË GRUPIT TË TRETË TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË MBROJTJES

Nr.	Pozicioni	Klasa	Shtesa për funksion drejtues sipas grupit përkatës
	Manovrator i makinerive të rënda	XIV	
	Ndihmësmannovrator i makinerive të rënda	XIII	
	Kryetar dege në arsimin parauniversitar Kujdestar në qendrat e përkujdesit social Përgjegjës ofiçine e transporti Përgjegjës grupi në drejtoritë rajonale të mirëmbajtjes së rrugëve dhe drejtorinë riparimit të makinerive të furnizimit në Tiranë	XI	3
	Sekretare në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit Shofer me automjete speciale Kryesondist	X	
	Ndihmësspecialist Meteorolog	IX	

	Ndihmësmjek Laborant Sekretar Sekretar shkolle në arsimin parauniversitar, në shkollat e mesme Kryekuzhinier Kryeinfermier Farmacist Arkivist Llogaritar, Ekonomist i mesëm Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton dhe i mjeteve speciale Anketues Motopompist		
3.	Sekretar shkolle në arsimin parauniversitar në shkollat 9-vjeçare Arkiviste gjyqësore në gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit Bibliotekar Programist Instruktor Metodist Kujdestar në qendrat e përkujdesit social Shofer transporti me automjet mbi 2.5 tonë Administrator i sistemeve të ndërlidhjes Polombar	VIII	
4.	Teknik i mirëmbajtjes së pajisjeve tokësore, ajrore, detare, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes Minator Ndërlidhës Piktur Disenjator Punonjës sekretarie	VII	
5.	Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme Teknik armatimi Kujdestar-magazininier (për armatime dhe të tjera) Përgjegjës i godinave të shtëpive të pushimit Teknik ndërtimi Fenerist detar Ekspeditor Dispeçer Infermier Kuzhinier Fotograf Fotoreporter Telekronist Zetorist Operator audioviziv Montazhier grafist	VI	
4.	Operator Shofer autoambulance	V	
5.	Kartelist Magazinier Evidencier	IV	

	Inventarizues Rrobaqepës Kamerier Kolaudator Kopjues notash Daktilografist, fotokopjues Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme Punëtorë të bazave prodhuese Shofer autoveture Shofer automjeti transporti deri 2.5 ton Rojë me armë Ftues Furnitor Fillrojtës		
6.	Ndihmëskuzhinier Kaldajist Drejtues të motoçikletave dhe motokarrove Punonjës ngarkim-shkarkimi Zhbllokues Garderobier Këpucar Berber	III	
7.	Lulishtar Pjatararës Rrobalarës Biletashitës Rojë pa armë Punonjës shërbimi	II	
8	Sanitar/pastrues Korrier Centralist	I	

Shënim. Në institucione qendrore të grupit të tretë të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes përfshihen të gjitha institucionet e klasifikuara në grupin e tretë në vendimin e pagave të punonjësve me arsim të lartë.

Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës

Lidhja II/2

PËR PUNONJËSIT E KLUBIT SPORTIV “STUDENTI”

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës klubi	XIV	4
2	Trajner	XIV	
3	Inspektor sportiv	XI	
4.	Kryetar i degës së financës	IX	1
5.	Përgjegjës i objekteve sportive	V	

Shënim. Për emërtesat të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja II/1 e vendimit.

Lidhja nr.II/3

NË DREJTORITË RAJONALE TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

Nr.rendor	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës
	Magaznier	VIII
	Punëtor ngarkim-shkarkimi	V
	Inventarizues. Punëtor	III

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja II/1 e vendimit.

Lidhja II/4

NË ADMINISTRATËN E INSTITUCIONEVE TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Nr.	Emërtimi	Klasa e pagës
1.	Shofer autoambulance, autoburgu Ndihmësmjek	IX
2.	Kujdestar. Infermier	VIII
3.	Ndihmësfarmacist & magazinier	VI

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja II/1 e vendimit.

Lidhja nr.II/5

RENDITJA E POZICIONEVE TË VEÇANTA TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË DREJTORITË RAJONALE TË MIRËMBAJTJES SË RRUGËVE DHE
DREJTORINË E RIPARIMIT TË MAKINERIVE TË FURNIZIMIT NË TIRANË

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës
	Teknik i mesëm. Normist	VII
	Punëtorë të mirëmbajtjes së rrugëve. Punëtor ofiçine	VI

Shënim.Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja II/1 e vendimit.

VENDIM
Nr.720, datë 22.6.2009

**PËR KALIMIN E TITULLIT TË PRONËSISË SË SIPËRFAQEVE, QË DO TË
TJETËRSOHEN, NË FAVOR TË SUBJEKTIT KËRKUES “MANE TCI” SHPK, PËR
LLOGARI TË FONDIT TË KOMPENSIMIT FINANCIAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të vendimit nr.12, datë 7.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për kushtet dhe procedurën e tjetërsimit të sipërfaqeve të tokës me cilësi të veçanta, për llogari të fondit të kompensimit financiar”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e së drejtës së pronësisë së pasurive të paluajtshme me nr.737 (vol.5, f.81, zona kadastrale 2529), me sipërfaqe 7 000 (shtatë mijë) m², dhe nr.863 (vol.4, f.62, zona kadastrale 2529), me sipërfaqe 2 400 (dy mijë e katërqind) m², të regjistruara në ZRVPP, Tiranë, në favor të subjektit kërkues “MANE TCI” sh.p.k.

2. Vlera e sipërfaqeve, që tjetërsohen, të përllogaritet sipas vendimit nr.139, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse, për qarqet e Fierit, të Elbasanit, Tiranës, Vlorës, Durrësit dhe Shkodrës.

3. Vlera e sipërfaqeve, që tjetërsohen, të paguhet nga subjekti kërkues “MANE TCI” sh.p.k., para lidhjes së kontratës dhe të derdhet për llogari të fondit të kompensimit financiar, të hapur pranë zyrës qendrore të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

4. Për lidhjen e kontratës së kalimit të së drejtës së pronësisë autorizohet drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

5. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, drejtori i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
.....	
KODI PENAL	226 lekë
.....	
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
.....	

Hyri në shtyp më 29.6.2009
Doli nga shtypi më 30.6.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë